

UDHËZIM
Nr. 6, datë 30.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURËN
E KOMANDIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 43, pika 6, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”,

UDHËZOJ :

1. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Përmbartimit.

2. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror mund të komandohet vetëm me pëlqimin e tij, për një periudhë jo më shumë se 1 (një) vit, me të drejtë rikomandimi.

3. Përmbartuesi gjyqësor shtetëror nuk lejohet të komandohet, kur:

- a) është në periudhë prove;
- b) është kryetar i zyrës përmbartimore;
- c) është i transferuar përkohësisht;
- ç) nuk garantohet përmbushja e funksionit me eficiencë dhe në kohë i zyrës përmbartimore ku ka emërimin;
- d) ka masë disiplinore në fuqi;
- dh) ka më pak se 2 (dy) vjet punë si përmbartues gjyqësor shtetëror.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, në bazë të vlerësimit të nevojave të punës, publikon në faqen zyrtare të saj kërkesën për kandidaturë për plotësimin e pozicionit të inspektorit përmes procedurës së komandimit.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit pranon kandidaturat e përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë që përmbushin kriteret specifike të pozicionit të inspektorit në strukturën përgjegjëse të saj për inspektimin.

6. Kërkesa qëndron e shpallur për një afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga publikimi dhe përmban informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë të inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin, si dhe përcakton:

- a) afatin e kandidimit, i cili është 2 (dy) javë nga data e shpalljes së kërkesës;
- b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit;
- c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

7. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

a) kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim në pozicionin e inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit;

b) jetëshkrim, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit;

c) aktin e emërimit si përmbartues gjyqësor shtetëror, të nxjerrë nga ministri i Drejtësisë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”;

ç) rekomandime për aftësitë organizative dhe të komunikimit, si dhe për të punuarit në grup;

d) çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit si inspektor.

8. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit mund të kërkojë informacion dhe të dhëna për kandidatët nga zyrat përmbarrimore përkatëse ku kanë emërimin, lidhur me aftësitë e tyre profesionale, organizative dhe etike të shfaqura gjatë ushtrimit të funksionit.

9. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, brenda 2 (dy) javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një relacion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të zyrës përmbarrimore vendore ku përmbarruesi gjyqësor shtetëror ushtron funksionin.

10. Struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit i paraqet drejtorit të përgjithshëm të Përmbarrimit për shqyrtim emrin/at e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit të inspektorit në strukturën përgjegjëse për inspektimin dhe propozimin për kandidatin fitues, si dhe emrin/at e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret, së bashku me relacionet përkatëse për secilin kandidat.

11. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të zyrës përmbarrimore vendore ku ushtron funksionin e tij, përjashtohet nga komandimi.

12. Drejtori i përgjithshëm i Përmbarrimit, pas kryerjes së verifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi, brenda 5 (pesë) ditëve nxjerr urdhrin për komandimin e përmbarruesit gjyqësor shtetëror të përzgjedhur, si inspektor në strukturën përgjegjëse për inspektimin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit.

13. Nëse asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet dhe/ose kriteret e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet për nevoja të punës komandimi, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit, mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë.

14. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja